



## UDHËZUES PËR PARASHTRIMIN E KËRKESËS PËR BLERJEN E BANESËS PËR TË CILËN EGZISTON E DREJTA BANESORE

Në bashkëngjitje të kërkesës për blerjen e banesës, pala duhet të dorëzoj Agjencisë Kosovare të Privatizimit (Komisionit për Shitjen e Banesave) **dokumentet (në original ose kopje të vërtetuar) si në vijim:**

1. Formulari i kërkesës për blerjen e banesës, i plotësuar. Formulari mund të tërhiqet në secilën zyre rajonale të Agjencisë, ose në faqen [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org) (Banesat);
2. Vendimi mbi ndarjen e banesës nga ndërmarrja shoqërore (NSH);
3. Kontratën për shfrytëzimin e banesës;
4. Kopja e letërnjoftimit për bartësin e të drejtës banesore;
5. Vërtetim për vjetërsinë e banesës. Vjetërsia e banesës është bazë për caktimin e çmimit të shitjes. Nëse nuk dorëzohet vërtetimi, Komisioni do të përcaktoj vjetërsinë duke u bazuar në datën kur është lidhur Kontrata për shfrytëzimin e banesës;
6. Kur të drejtën banesore e ka fituar njëri nga bashkëshortët të cilët jetojnë në familjen e përbashkët, bartës i të drejtës banesore konsiderohet edhe bashkëshorti tjetër. Të dy bashkëshortët duhet të parashtrojnë kërkesë kurse njëri nga ata vetëm me pajtim të tjetrit. Pajtimi jepet përmes deklaratës së vërtetuar në Gjykatë ose tek noteri. Gjithashtu duhet të prezantohet Certifikata e kurorëzimit si dëshmi e martesës dhe kopja e letërnjoftimit për bashkëshortin/ën. Nëse bashkëshorti/ja e bartësit të drejtës banesore nuk është gjallë, prezantohet Certifikata e vdekjes për të;
7. Në rast se bartësi i së drejtës banesore nuk është gjallë, të drejtën për të paraqitur kërkesë për blerjen e banesës e ka bashkëshorti/ja e bartësit të së drejtës banesore. Nëse edhe bashkëshorti/ja e bartësit të së drejtës banesore nuk është gjallë, atëherë si parashtrues të kërkesës për blerjen e banesës paraqiten anëtarët tjerë të ngushtë të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës banesore me pëlqimin e tij të dhënë gjatë jetës ose pas vdekjes së tij ose me aktvendim të trashëgimisë;
8. Anëtarë të ngushtë të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës banesore konsiderohen: bashkëshorti, fëmijët e lindur në martesë dhe jashtë martesë, të adaptuarit, thjeshtit, njerka, adaptuesi, si dhe personat e tjerë të cilët bartësi i së drejtës banesore ka për detyrë t'i mbajë sipas ligjit, apo këta persona sipas ligjit, kanë për detyrë të ushqejnë bartësin e së drejtës banesore, e të cilët bashkëjetojnë;
9. Anëtarët e ngushtë të bashkësisë familjare me rastin e parashtrimit të kërkesës duhet të prezantojnë dokumentet si në vijim: Certifikatën e vdekjes, Aktvdekjen për bartësin e së drejtës banesore, Certifikatën e vdekjes për bashkëshortin/ën e bartësit të së drejtës banesore, certifikata e kurorëzimit, dhe kopjet e letërnjoftimit për të gjithë anëtarët e ngushtë të bashkësisë familjare që paraqiten si parashtrues të kërkesës;
10. Nëse anëtarët e ngushtë të bashkësisë familjare shprehin vullnetin që banesa të bartet në emrin e njërit prej tyre, në atë rast kërkohet deklarata me shkrim e vërtetuar në gjykatë ose tek noteri e secilit anëtarë të familjes, përmes së cilës ata shprehin pëlqimin e tyre që pronësia e banesës të bartet vetëm në njërin nga anëtarët e familjes.